



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MBROJTJES / MINISTARSTVO ODBRANE / MINISTRY OF DEFENSE	
Nr.Prot: Br.Prot: No.Prot:	3840
Nr. i Faqevë Br. Stranica No. of pages:	8
Data: Datum: Date:	08 / 07 / 2025
Prishtinë - a	

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mbrojtjes

Ministarstvo Odbrane / Ministry of Defense

Kabineti i Sekretares së Përgjithshme / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	08.07.2025
REFERENCË:	3/458/2025
PËR/ZA/TO:	Vlora SPANCA Auditore e Përgjithshme e Republikës së Kosovës Zyra Kombëtare e Auditimit
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Ejup Maqedonci - Ministër në detyrë i Ministrisë së Mbrojtjes
NGA/OD/FROM:	Gafurr Dugolli- Sekretar i Përgjithshëm në MM
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Plani Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit nr. 3294 të datës 09.06.2025

E nderuar,

Bazuar në nenin 23 paragrafi 5 të Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, përmes kësaj shkrese ju përcjellim:

- Planin e Veprimit të Ministrisë së Mbrojtjes për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit nr. prot: 3294, të datës 09.06.2025

Me respekt!

Emri i Auditimit: PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË MBROJTJËS PËR VITIN 2024

**- Plani i Veprimit të Menaxhmentit -**

Për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit  
Nr. prot: 3294, të datës 09.06.2025.

Nr.	Rekomandimet	Veprimi i menaxhmentit	Data e planifikuar për përfundim	Personi përgjegjës
1.	<p>Çështja A1. Vonesa në përmbushjen e kontratave. Ministri duhet të siguroj përmes menaxhereve përkatës që janë ndërmarrë veprimet konkrete dhe me kohë për eliminimin barrierave të ndryshme dhe krijimin e parakushteve për pranimin e mallit ,duke mundësuar përmbushjen e secilës kontratë sipas afateve të përcaktuara.</p>	<p>Menaxherët e kontratave përveç raportimeve të rregullta mujore, të raportojnë te ZKA dhe njësia kërkuese edhe për porosit e bëra sipas Urdhër blerjeve, një javë më herët para se të bëhet liferimi i kërkesës. Po ashtu Zyrtari Certifikues të shtoj kontroll më të madh gjatë certifikimit te lëndëve për ekzekutimin e shpenzimit dhe të vërtetoj korrespondencat në mes OE dhe menaxherit përkatës në rast të mos respektimit të afateve për liferim. Zyrtari Certifikues të mbajë evidencë për çdo parregullsi eventuale të lëndëve</p>	<p><b>Për çdo rast</b> Do të shtohen kontrollat si dhe do të shiqohet çdo dokument apo korrespondencë në mes të OE dhe AK Për çdo rast/ lëndë të pakompletuar dhe të pa qartë do të bëhet njoftimi i ZKA-s dhe departamenteve përkatëse</p>	<p>ZKA Menaxherët e Kontratave Zyrtari Certifikues FSK</p>

Emri i Auditimit: PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË MBROJTJËS PËR VITIN 2024

**- Plani i Veprimit të Menaxhmentit -**Për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit  
Nr. prot: 3294, të datës 09.06.2025.

Nr.	Rekomandimet	Veprimi i menaxhmentit	Data e planifikuar për përfundim	Personi përgjegjës
1.	<p><b>Çështja A1. Vonesa në përmbushjen e kontratave.</b> Ministri duhet të siguroj përmes menaxhereve përkatës që janë ndërmarrë veprimet konkrete dhe me kohë për eliminimin barrierave të ndryshme dhe krijimin e parakushteve për pranimin e mallit ,duke mundësuar përmbushjen e secilës kontratë sipas afateve të përcaktuara.</p>	<p>Menaxherët e kontratave përveç raportimeve të rregullta mujore, të raportojnë te ZKA dhe njësia kërkuese edhe për porosit e bëra sipas Urdhër blerjeve, një javë më herët para se të bëhet liferimi i kërkesës. Po ashtu Zyrtari Certifikues të shtoj kontroll më të madh gjatë certifikimit të lëndëve për ekzekutimin e shpenzimit dhe të vërtetoj korrespondencat në mes OE dhe menaxherit përkatës në rast të mos respektimit të afateve për liferim. Zyrtari Certifikues të mbajë evidencë për çdo parregullsi eventuale të lëndëve</p>	<p><b>Për çdo rast</b> Do të shtohen kontrollat si dhe do të shiqohet çdo dokument apo korrespondencë në mes të OE dhe AK Për çdo rast/ lëndë të pakompletuar dhe të pa qartë do të bëhet njoftimi i ZKA-s dhe departamenteve përkatëse</p>	<p>ZKA Menaxherët e Kontratave Zyrtari Certifikues FSK</p>

		<p>për çertifikim shpenzimi dhe pagese dhe të raportoj tek ZKA dhe të mbaj të informuar edhe D. Prokurimit, D.Logjistikes dhe D. Financave për veprimet që duhet ndërmarrë.</p>		
<p>2.</p>	<p><b>Çështja A2. Dobësi në menaxhimin e proceseve në fushën e personelit. Ministri përmes menaxherit të personelit dhe komisioneve rekrutuese duhet të siguroj një proces të drejtë duke forcuar mekanizmat e kontrollit të brendshëm ne proceset e ardhshme të rekrutimit. Po ashtu, duhet të ndërmerren të gjitha veprimet ligjore për mbulimin e pozitave me ushtrues detyre me pozita të rregullta</b></p>	<p>Menaxheri i personelit duhet që para se ti dorëzoj listën e aplikanteve komisioneve rekrutuese, ti ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme dhe të siguroj se aplikuesit i plotësojnë të gjitha kushtet sipas pozitave dhe te parapara sipas konkurseve të shpallura. Menaxheri i Personelit ti rishikoj të gjitha pozitat të cilat janë me ushtrues detyre të cilat janë me shumë se gjashtë muaj dhe ti ndërmerr veprimet e nevojshme për mbulimin e tyre me planin e</p>	<p><b>-Në çdo rast të rekrutimit sipas planit të rekrutimit për vitin 2025.</b> -Të gjitha pozitat te cilat kane qene me ushtrues detyre janë marrë në konsideratë dhe janë zhvilluar procedurat e rekrutimit sipas procedurave të aplikueshme ligjore. Këto veprime i kemi ndërmarr gjatë fazës së auditimit nga ekipi e auditorëve të cilët kanë qene në teren tek ne në MM.</p>	<p>Departamenti i Personelit-MM</p>

		rekrutimit për vit fiskal dhe të shpallen pozitat për mbulimin e tyre me proceset e rregullta të rekrutimit.		
3.	<p><b>Çështja C1 Kompensimi jo i plotë për punën jashtë orarit-kujdestarisë.</b>  <b>Ministri duhet të përshpejtoj procesin e rishikimit të rregullores aktuale për orarin e punës, duke i përshtatur me aktivitetin e saj dhe të siguroj një rregullim të qartë në lidhje me kompensimin e punës jashtë orarit, qoftë me pagesë apo me ditë pushimi në mënyrë që të gjithë pjesëtarët të cilët shërbejnë jashtë orarit të kompensohen në përputhje me legjislacionin në fuqi</b></p>	<p>Ministria e Mbrojtjes do të angazhohet që Grupi Punues për për ndryshimin dhe plotësimin e rregullorës MM nr. 10/2019 për orarin e punës në Forcën e Sigurisë së Kosovës të përfundoj punën në përputhje me afatet ligjore, dhe pas kësaj faze, do të merren hapat e duhur që çështja e kompensimeve për punë jashtë orarit të punës të ketë bazën e saktë ligjore.</p>	<p><b>Në proces</b>  Në përputhje me Planin e akteve nënligjore të MM-së për vitin 2025, miratuar nga ministri mbrojtjes, kjo Rregullorje mbyll afatin e konsultimeve publike me 13 korrik, dhe pas kësaj date, në kohën më të shkurtër të mundshme, do të filloj se zbatuari.</p>	<p>Departamenti i Personelit, Zyra Ligjore në MM dhe ZKA</p>
4.	<p><b>Çështja C2 Mangësi në menaxhimin e barnave.</b>  <b>Ministri duhet të siguroj se menaxhimit të barnave i paraprinë një vlerësim real i nevojave nga njësitë e kërkesave duke shërbyer ata me informata të sakta mbi</b></p>	<p>Të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme për evidentimin e nevojave për furnizime me barna dhe të bëhen porositë sipas nevojës. Po ashtu edhe gjatë përgatitjes së specifikave të kontratave për</p>	<p><b>Në proces</b>  Barnat me afat të skaduar janë të deponuara dhe pritet asgjësimi i tyre. Çështja e barnave pa afat është problem në nivel vendi, kemi biseduar për asgjësimin e tyre me MSH, dhe ata na kanë premtuar që</p>	<p>Departamenti i Logjistikes-MM, ZKA  DPR  G4/SHP  KL/RMFSK</p>

	<p>gjendjen stokut në depo. Hyrje daljet e barnave nga depoja duhet të bëhen përmes e-pasurisë në mënyrë që të ketë pasqyrë gjatë gjithë kohës në mënyrë që mos të ketë grumbullim të barnave jashtë afatit</p>	<p>furnizime me barna të shihet mundësia që OE i cili bënë furnizimin e barnave të ketë mundësin e ndërrimit të barnave para se ti skadoj afati i tyre se paku tre muaj më herët dhe të zëvendësohen me të njëjtat, gjithherë duke respektuar kushtet e kontratave. Personat përgjegjës ti ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për evidentimin e tyre përmes sistemeve të aplikueshme të cilat janë në përdorim, po ashtu edhe te behet një raport mbi gjendjen e stokut të barnave si dhe gjendjen aktuale të stokut. Të formohet një komision për rregullimin dhe verifikimin e gjendjes së stokut. Po ashtu, do te kërkohet raportim në baza mujore rreth gjendjes së barnave.</p>	<p>në momentin që do të bëjnë ndonjë zgjidhje për këtë çështje, do te marrin edhe barnat me afat të skaduar nga FSK-ja. Në të ardhmën do të shikohet mundësia e ndërrimit me Departamentin e Farmacisë në MSH.</p>	
<p>5.</p>	<p>Çështja A3. Mangësi në fushën e prokurimit. Ministri duhet të siguroj përmes menaxherëve të prokurimit dhe komisioneve vlerësuese një proces vlerësim të drejt të ofertave bazuar në kriteret e dosjes të tenderit dhe monitorim të rregullt e sistematik të</p>	<p>Departamenti i Prokurimit për çdo aktivitet të prokurimit ti ndërmerr të gjitha veprimet paraprake me qëllim të respektimit të kriterëve të vendosura në dosjen e tenderit në njoftimin për kontratë dhe të respektohen ligjet dhe rregulloret</p>	<p><b>Në proces</b> Do ti ndërmarrim të gjitha veprimet që në të ardhmen mos të ndodhin dhe me kohë do t’ju kerkohet zgjatja e validitetit të ofertave në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimi publik</p>	<p>ZKA D. Prokurimit D. Logjistikes</p>

	<p>afateve në lidhje me validitetin e ofertave kur proceset e vlerësimit të tenderëve për arsye të justifikueshme zgjasin përtej afateve</p>	<p>e aplikueshme në fuqi. Po ashtu nga ana e komisioneve të kenë kujdes gjatë vlerësimit të kritereve sipas kërkesave të dosje së tenderit. Menaxheri - zyrtarët e prokurimit të bëjnë verifikimin e kritereve dhe raporteve të komisioneve me qëllim të mos anashkalimit të kritereve të vendosura të cilat do të shkaktojnë rrezik në dështimin e procesit të prokurimit për çdo aktivitet.</p>		
<p>6</p>	<p><b>Çështja B1. Mangësi në menaxhimin e pasurive përmes sistemit e-Pasuria. Ministri duhet të siguroj përmes menaxherit të financave që pasuritë nën 1,000€ janë prezantuar në mënyrë të plotë dhe të saktë në PFV. Po ashtu Ministria duhet të ndërtoj një bashkëpunim efektiv me mirëmbajtësin sistemit e-pasuria për eliminimin e gabimeve gjatë tërë vitit në mënyrë që sistemi e-pasuria të gjeneroj me saktësi pasurinë e regjistruar.</b></p>	<p>Departamenti i Financave në bashkëpunim me Departamentin e Logjistikes në MM ti ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për rregullimin e kësaj çështje dhe të bëhen rregullimet e duhura sipas gjetjeve nga ana e ZKA. Të formohen komisionet ad-hoc për këtë çështje dhe të kontaktohen aktoret relevant për mbështetjen e evitimit të këtyre parregullsive të paraqitura në sistemin e-pasuria. Komisionet të paraqesin raportin përfundimtar me gjendjen e stoqeve pas rregullimeve.</p>	<p><b>Në proces</b></p>	<p>ZKA D. Logjistikes D. Financave</p>

7	<p><b>Çështja 4. Prezantimi jo i saktë i detyrimeve kontingjente.</b>  <b>Ministri duhet të siguroj një koordinimi ne mes zyrës ligjore dhe ZKF në mënyrë që detyrimet kontingjente të jenë të përditësuara në fund të vitit me qëllim që të prezantohen drejtë dhe në përputhje me kërkesat e rregullorës për Raportim Vjetor Financiar.</b></p>	<p>Drejtori i Departamentit Ligjor në bashkëpunim me ZKF dhe akteret tjerë të bëjnë përditësimin e listës së detyrimeve kontingjente.</p>	<p>Në vazhdimësi dhe sipas Rregullores për Raportim Vjetor Financiar</p>	<p>Departamenti Ligjor</p>
---	---	---	--	----------------------------

Menaxheri i aktivitetit / procesit të audituar: Ministria e Mbrojtjes